



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 1249 Prot.

Durrës, më 23 /01.2024

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHURAVE
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE


Tiranë

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, Kreu VI “Njoftimi i Vendimit”, pika 3, a) “Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit”, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi i Vendimit Administrativ të Degës së Doganës Durrës për subjektet / shtetasit, me të dhëna të evidentuara më poshtë:

Nr	Vendim Data	Emertimi I Subjektit	NIPT-i	Detyrimi	Penalitete	Shuma
1	70 17.01.2024	SHKELZEN GJOCAJ	L00013277P	7,642	0	7,642

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI
DENIS SHABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE DURRËS

Nr. 891 Prot.

Durrës më, 17/01/2024

V E N D I M N R. 7 0

Sot, me datë 17.01.2024, pasi shqyrtova materialin e plotë bashkëngjitur shkresës me nr. 16/29 Prot., datë 05.10.2022 (nr. 615/50 Prot., datë 07.10.2022 i DDD) “Dërgimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet për auditimin” të Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të Degës së Doganës Durrës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021”; Urdhërit të Brendshëm të Degës së Doganës Durrës me nr. 41/615/51 Prot., datë 11.10.2022 dalë me qëllim marrjen e masave të plota për shqyrtimin, analizimin dhe përmbushjen e rekomandimeve sipas Aneksi 3.37, shkresën e DDD “Dërgim të konstatimeve dhe rekomandimeve të KLSH-së” me nr.20735 Prot., datë 21.12.2023

K O N S T A T O V A S E:

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në shkresën me nr. 16/29 Prot., datë 05.10.2022 (nr. 615/50 Prot., datë 07.10.2022 i DDD) “Dërgimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet për auditimin” të Kontrollit të Lartë të Shtetit me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të Degës së Doganës Durrës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021” është konstatuar se:

Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruar në Kapitullin *73* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH për mallin e deklaruar “*Panele Sanduic te përdorur*” konstatohet se nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas kriterëve dhe përcaktimeve të trajtuara më lart. Nga personeli përpunues doganor nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i pikës 10 të Udhëzimit 3, datë 23.01.2018 “Për Vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” që lidhen me vlerësimin doganor “Përdorimi i metodave të tjera” pika 10/h “Kur importohen mallra të përdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre, nga dega doganore apo strukturat e posaçme, ngrihet “grup vlerësimi”, që merr në konsideratë sipas rastit, vitin e prodhimit, shkallën e amortizimit, gjendjen reale të tyre etj., por jo më pak se 40% të vlerës të mallit të ri”. Artikujt e mëposhtëm duhet të ishin trajtuar me nivel vlerësimi në nivelin jo më pak se 40% e vlerës së mallit “*Panele Sanduic te përdorur*” llogaritur sipas të Dhenave të Dosjes të Disponueshme për artikullin Panele Sanduic sipas karakteristikave dhe cilësive të spesoreve të detajuara në Dosjen e të Dhenave të Disponueshme në RSH. Trajtuar në praktikën doganore në tabelën anekse të këtij Raport Auditimi edhe tabelë e rasteve ku nuk është marrë në konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm për mallrat e deklaruar në kapitullin *73* të natyrës “*Panele Sanduic te përdorur*” sipas Nomenklaturës së Mallrave në RSH.

Gjithashtu janë trajtuar rilogaritje të detyrimeve doganore të papaguara edhe për artikujt :

1-Artikullin “*Artikuj metalik te përdorur*” të rivlerësuar me 0.7 Euro/kg sipas kushtit të lëvrimit Fob.

2-Artikullin “*Depozita të përdorura*” të rivlerësuar me 0.78 Euro/Kg sipas kushtit të lëvrimit Fob për nivelin e vlerësimit jo më pak se 40% e vlerës së mallit të ri i cili kuotohet në nivelin 1.3 Euro/kg për mallra me origjinë EU dhe 1.3Usd/kg për mallra me origjinë NEU

3-Artikujt “*kazan metalik, konstruksione metalik, profile metalike, skela metalike etj*” të përdorura të rivlerësuar me 0.7 Euro/Kg sipas kushtit të lëvrimit Fob.

... artikullit doganore në tabelën anekse të këtij Raport Auditimi edhe tabela e rasteve ku nuk
... konsideratë përcaktimi ligjor i mesiperm për mallrat e deklaruar në kapitullin *73* të
... *alkuj metalik te përdorur*, *depozita të përdorura*, *kazan metalik, konstruksione*
... *profile metalike, skela metalike etj*” sipas Nomenklatures së Mallrave në RSH

... vitin 2021 përmes deklaratës doganore Imp.4 R.22416 shoqëria / shtetasi “Shkelzen Gjocaj” me
... Nipt/ID L00013277P e përfaqësuar nga agjensia doganore “Spedalb AD” ka deklaruar pranë Degës së
... Doganës Durrës për qarkullim të lirë artikullin “skele metalike/përdorur”, praktikë e cila brenda afatit
... është rishikuar aposteriori dhe është konkluduar në:

DAV	Nipti	Kap	Malli	Pesha	VL/EU/Kg	Cmim/altern	Detyrim
22416	L00013277P	73	Skele te përdorura	1000	0.59	0.70	7642

Detyrimi doganor i munguar i cili duhet të rikuperohet si borxh doganor, sipas konstatimit të
KLSH-së, i është dërguar për njoftim nëpërmjet shkresës me nr. 20735/46 Prot., datë 26.12.2023
me shërbimin postar Posta Shqiptare, nuk rezulton që është ushtruar ankesë.

Përsa më sipër në bazë të neneve 49, 70 e vijues, 169, 261, 273 e vijues, 276 të Ligjit nr. 102/2014,
datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, të VKM –së nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e
dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”; të Udhëzimit Nr.03 datë 23.01.2018
të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”

V E N D O S A :

1. Shoqëria/subjekti “Shkelzen Gjocaj” me Nipt/ID L00013277P të paguajë detyrimin doganor të rivlerësuar në shumën **7642 lekë**.
2. Për të proceduar më tej ngarkohen: Zyra e Financës, Zyra Aposteriorit si dhe Zyra e Borxhit në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi.
3. Kundër këtij vendimi mund të ushtroni ankim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave sipas nenit 281 e 282 të Kodit Doganor në fuqi. Kërkesa ankimore e arsyetuar duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit/eksportit si dhe duke garantuar për DPD-në shumën e sanksioneve të aplikuara për këtë shkelje.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Denis SHABANI